



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
PORTI DETAR SH.A SHËNGJIN

Nr. 978 Prot.

Shëngjin, më: 01/10/2025

LËNDA: SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në ligjin numër 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr 7961 date 12.07.1995 “ Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, vendimi nr 15 datë 20.12.2024 të Këshillit Mbikqyres, mbi miratimin e strukture organizative të drejtorisë së Portit Detar Shëngjin; Rregullores së Brëndshme të drejtorisë së Portit Detar Shëngjin, të miratuar me vendimin nr. 10 , datë 21.09.2023 të Këshillit Mbikqyres;

Drejtoria e Portit Detar Shengjin Sh.a shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin “**Specialist Informacioni**” në Portin Detar Shëngjin sh.a.

Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë Sh.A Portit Detar Shëngjin në zarf të mbyllur. Njoftimi është shpallur në faqen zyrtare web: www/portidetarshengjin.al

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme te Portit Detar Shëngjin sh.a

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

- Të jetë shtetas/e shqipar/e
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- Duhet të ketë karakteristikat dhe integritet moral në përputhje me legjislacionin e republikës së Shqipërisë.
 - Të mos ketë qenë i dënuar për vepra penale
 - Të mos jetë nën hetim për vepra penale

- Të mos jetë përjashtuar me masë nga funksioni që ka kryer më parë për veprime të jashtëligjshme.

Kriteret e Veçanta:

Arsimi: Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë, shkencë të natyrës, ekonomik. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvojë: Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite eksperiencë pune në administratë.

Njohuri të tjera (plotësuese):

Kualifikimet, Trajtime dhe të kenë njohuri të mira kompjuterike.

Sa më sipër, dokumentat që kërkohet të dorëzohen janë:

- 1- Letërnjoftim ID
- 2- CV
- 3- Diplomë (te njësuar me origjinalin)
- 4- Certifikatë familjare
- 5- Dëshmi Penaliteti
- 6- Raport aftësie për punë
- 7- Dokumenta plotësuese (kualifikime, trajtime, njohuri kompjuterike)

Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë SH.A Portit Detar Shëngjin nga data 01/ 10/ 2025 deri me datë 30/ 10 / 2025.

DREJTOR

Sandër Marashi

